REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**BORDI I ADMINISTRIMIT**
**VENDIM**
**Nr. 12 , datë 15/ 04/ 2019**
**MBI**

# ‘‘MIRATIMIN PARAPRAK, PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT SKULPTURË, SKULPTURË QERAMIKË, PIKTURË KAVALETI, PIKTURË MONUMENTALE, GRAFIKË, TEKSTIL DHE MODË DHE MULTIMEDIA, TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE BACHELOR, NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE’’

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 18, datë 09.04.2019 “Miratimin paraprak, për riorganizimin e programeve të studimit Skulpturë, Skulpturë Qeramikë, Pikturë Kavaleti, Pikturë Monumentale, Grafikë, Tekstil dhe Modë dhe Multimedia, të ciklit të parë të studimeve Bachelor, në Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve”; Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 29.12.2017 ‘‘Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë’’ dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Fakulteti i Arteve të Bukura, pasi e diskutoi me votim të hapur,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin paraprak, për riorganizimin e programeve të studimit Skulpturë, Skulpturë Qeramikë, Pikturë Kavaleti, Pikturë Monumentale, Grafikë, Tekstil dhe Modë dhe Multimedia të ciklit të parë të studimeve Bachelor, në Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit së Arsimit Sportit dhe Rinisë për miratim përfundimtar.

3. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**<u>BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE</u>**

**Prof. Besnik BISHA (Kryetar)** **Risena XHAJA (Anëtar)**

_______________ _______________

**Prof. Arben BASHA (Anëtar)**

______________________

**Aida MARTIRO (Anëtar)**

______________________

**Prof. Artan PEQINI (Anëtar)**

______________________

**Prof. Bujar KAPEXHIU (Anëtar)**

______________________

**Lorenc VANGJELI (Anëtar)**

______________________

Nr. 398 Prot
20.03.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA**
**DEKANI**

# URDHËR

**Nr. 1, Datë 11.01.2019**

**PËR**

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TE STUDIMIT PIKTURË DHE SKULPTURË NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR**

Bazuar ne ligjin Nr. 80/2015 ( neni 35 ) për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë , në Udhëzimin nr. 31 dt. 29.12.2017 i MARS për për hapjen dhe/ose organizimin e programeve të studimit.

**URDHËROJ:**

1. Riorganizimin e programeve të studimit Pikturë dhe Skulpturë në Ciklin e Parë Bachelor në:

   Pikturë Kavaleti, Pikturë Monumentale si pjesë të struktureë së Njesisë Bazë Pikture, Pikturë Multimedia, Pikturë Grafikë, Pikturë Tekstil dhe Modë si pjesë e së Njesisë Bazë të Arteve të Aplikuara dhe Skulpturë, Skulpturë Qeramike si pjesë e strukturës së Njesisë Bazë Skulpturë.

2. Dosja e përgatitur për këto programe të kalohet në Senatin e Universitetit të Arteve për miratim.

**PROF. ASOC. ARDIAN ISUFI**

**DEKAN**
**FAKULTETI ARTEVE TË BUKURA**